



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I ARTEVE


Rr. Agim Ramadani, Fakulteti I Arteve, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 247 129 • E-mail: arte@uni-pr.edu

Tezat e masterit për diskutim publik të miratuara nga Dega e Arteve
Dramatike, Moduli: DRAMATURGJI

Me datë: 19. 02. 2025

Nr.	Kandidat	Titulli i temës	Komisioni
1.	Hynor Vitija	Komedia “Zhurmat”	1. Prof. dr. Emin Emini 2. Prof. Zymber Kelmendi 3. Prof. dr. Seadet Begiri(mentore)

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I ARTEVE DEGA E ARTEVE DRAMATIKE
DREJTIMI DRAMATURGJI



PUNIM DIPLOME

MENTORE:

PROF. DR. SEADET BEQIRI

KANDIDATI:

HYNOR VITIJA

English

Synopsis

Elena and Gentiani, a couple in their forties, are trying to have a child, but their efforts have been unsuccessful. Their attempts lead to constant tension and arguments, which often escalate into uncomfortable situations. Meanwhile, their neighbors, Maria and Semi, are facing their own relationship challenges, which come to a head, especially on Valentine's Day.

The noise and arguments between the two couples lead to constant interference from Maria, who complains about the lack of peace. Gentiani, with his carefree nature, and Semi, with his strange behavior, only complicate things further, causing misunderstandings and awkward moments.

Unable to find a solution to their problems, both couples end up in therapy sessions, where they confront their truths in bizarre ways. Gentiani doesn't take the therapy seriously, Semi tries to convince Maria of his ideas, while Elena and Maria lose patience with their partners.

Meanwhile, Gentiani's mother, Sebi, intervenes with her traditional fertility advice, bringing honey and unconventional methods to help the couple conceive. Her presence creates even more absurd and comedic situations.

In the end, Elena finds out she is pregnant, bringing joy to the family. However, the excitement fades when Gentiani discovers he is sterile. In a frozen moment, everyone turns to look at Semi, implying a major mix-up that remains unclear.

Shqip

Synopsis

Elena dhe Gentiani, një çift në të dyzetat, po përpiqen të bëhen me fëmijë, por pa sukses. Përpyekjet e tyre sjellin tensione dhe debate të vazhdueshme, të cilat shpeshherë degjenerojnë në situata të palakmueshme. Ndërkohë, fqinjët e tyre, Maria dhe Semi, kanë sfidat e tyre në marrëdhënie, të cilat shpërthejnë veçanërisht gjatë Ditës së të Dashuruarve.

Zhurmat dhe debatet mes dy çifteve bëhen shkak për ndërhyrjen e vazhdueshme të Marias, e cila ankohet për paqetësi. Nga ana tjetër, Gentiani me natyrën e tij të lirshme dhe Semi me sjelljen e tij të çuditshme, e komplikojnë edhe më shumë situatën, duke shkaktuar keqkuptime dhe momente të sikletshme.

Duke mos gjetur zgjidhje për problemet e tyre, të dy çiftet përfundojnë në seanca terapie, ku përballen me të vërtetat e tyre në mënyrë të çuditshme. Gentiani nuk e merr seriozisht terapinë, Semi përpiqet të bindë Marian për idetë e tij, ndërsa Elena dhe Maria humbin durimin me partnerët e tyre.

Ndërkohë, nëna e Gentianit, Sebi, ndërhyr me këshillat e saj tradicionale për fertilitetin, duke sjellë mjaltë dhe metoda të çuditshme për të ndihmuar çiftin të bëhet me fëmijë. Prania e saj krijon situata edhe më absurde dhe komike.

Në fund, Elena mëson se është shtatzënë, duke sjellë gëzim në familje. Por entuziazmi shuhet kur Gentiani zbulon se është steril. Në një moment të ngrirë, të gjithë kthejnë kokën nga Semi, duke lënë të nënkuptohet një ngatërresë të madhe.

Zhurmat

komedi

Nga

Hynor Vitija

Name Hynor Vitija

Address hynorvitija@gmail.com

Phone Number +38344879625

PERSONAZHET	PËRSHKRIMI I TYRE	MOSHA	GJINIA
Elena	Amvise, grua e dashur.	40	Femër
Gentiani	Njeri i dhënë pas punës, avanturier.	40	Mashkull
Semi	Njeri beta, i gatshëm për gruan e tij.	27	Mashkull
Maria	Femër Alfa, njeri i dhënë pas vetës.	23	Femër
Sebi	Nëna e Gentianit, mjeke popullore.	65	Femër

Një apartament i thjeshtë i një familje mesatare. Elena(40) vjen nga banja dhe me shumë siklet e shikon testin e shtatzanisë. Është NEGATIV.

Ajo e gjuan testin dhe në atë moment dera hapet, hyn Gentiani(40) i gjuan palltën dhe vjen tek kjo me shpejtësi.

Zbathë çorapet i gjuan pa kujdes dhe rehatohet.

GENTIANI

Hë, Pozitiv a po?

ELENA

Jo. Negativ.

GENTIANI

Qysh është e mundur edhe e futa jastakun poshtë shpinës tënde, si në video.

ELENA

Ndoshta, është dashtë me futë diçka tjetër ma me koncentrim.

GENTIANI

Ta merr mendja që është faji im.

ELENA

Pse i imi?

GENTIANI

Ti je ajo që po e hudhë fajin, çka po pret? Ta lë fajtor vetën?

ELENA

Kur është nevoja po.

Ajo e shikon Gentianin me kujdes.

ELENA

Nuk ke ble asgjë tjetër?

GENTIANI

Pse çka duhet t'blejë?

ELENA

Perzervativë Gentian!

GENTIANI

Pse a nuk do t'mundohemi më?

ELENA

Është dita e të dashurveve o i mjerë.

GENTIANI

Aaa... tash mu kujtu pse t'gjitha gratë në punë kishin lule. Po prit, ti po mendon që kam harru të blej dhuratë.

ELENA

Po sigurisht ke harru.

GENTIANI

Unë të harroj për ty ... kur ka ndodhur kjo?

ELENA

Hiç ma pak se pesë shën valentinat e fundit.

GENTIANI

Të shkuara të harruara zemër...

Ai i nxerrë disa të holla nga xhepi i tij, i mer edhe disa cent nga xhepi tjetër.

GENTIANI

Ja zemër, shko edhe blej çfarë të duash. Veç jo perzervativ. Hahaha.... A nuk jam burri më i mirë në botë?

ELENA

Po si nuk je? Ti nuk e di si t'ka kriju ajo nana jote...

GENTIANI

Me pak spermë nga baba... hahaha....

Ajo ja gjuan paratë për fytyrë.

GENTIANI

Ngadalë zemër, më fal....

ELENA

A e di çka m' tha një shoqe, që stresi dhe paknaqësia e bëjnë më të vështirë mundsinë me mbetë shtatzanë.

GENTIANI

Qenka shumë e lehtë, vetëm heke stresin zemër.

Ajo vetëm e shikon.

ELENA

Po ti mirë e ke, se unë e kam një buton mbrapa kokës edhe ma heqë stresin... bile, ma reseton komplet kujtesën dhe harroj se çfarë IDIOTI JE!

Ai largohet nga ajo.

Zilja bie.

Gentiani shkon dhe e hapë derën, aty është Maria(23).

GENTIANI

Përshëndetje si je?

MARIA

Po bëni shumë zhurmë.

GENTIANI

Po e di, gruaja është pak nervoze...

ELENA

Gentian.

GENTIANI

....edhe pak xheloze.

MARIA

Nuk është hera e parë, t' lutna sa ma qetë.

GENTIANI

N'rregull, kërkohet falje. Shumë bukur flokët....

Elena e dëgjon dhe afrohet tek aj.

GENTIANI

Shumë i ngjanë asaj aktorës së filmave, nuk po m'kujtohet emri... me N-ë....

ELENA

Natalia...

GENTIANI

Po zemër, Natalia, faleminderi shumë...

(në atë moment e kupton që Elena është aty.)

Ni shok më ka pyet për ty, a t'ja jap numrin e telefonit?

MARIA

Jo... ditën e mirë!

GENTIANI

Mos u ngut, nuk dihet kurr se ku godet në shenjë.

Ajo largohet.

ELENA

Ti, zotri producent, a nuk ke punë më të mirë veç me flirtu me gratë e huja.

GENTIANI

T'lutna zemër, gratë nuk janë pronë e askujt.

ELENA

Oo zotri feminist.

GENTIANI

E vërtetë, kam mendu të angazhohem në ndonjë protestë. Ti e di që jam tip revolucionar. Apo jo?

Elena e godet Gentianin.

ELENA

E po ta dish që k'shtu nuk funksionon ma. Me gjithë stresin që po ma jep edhe me këto sjellje tua, nuk çuditem që nuk mbetem shtatzanë... nesër shkojmë tek terapistja e çifteve pikë.

GENTIANI

Sssss... nesër kam takim pune, bordi...

ELENA

Nuk më intereson, edhe sikur dielli të bie n'tokë, ti do jesh aty.

Gentiani shqetësohet.

GENTIANI

N'rregull zemër... Po puna e kohës.

ELENA

Mos e mendo kohën, do shkojmë te psikologja që është në ndërtesë tonë.

GENTIANI

Ajo që është dy kate më lart?

ELENA

Ku e din ti sa kate lart është?

GENTIANI

Po një ditë i ndihmova me disa libra. Ishin shumë të rëndë.

ELENA

E tash e marr vesh unë.

GENTIANI

Po tash u lidh biseda.

ELENA

Ti nuk përmisohesh!

Elena e shikon me nervozë.

APARTAMENT I MARIAS DHE SEMIT

Në apartmentin tjetër ka lule në tokë, disa dhurata në shtrat dhe aty është SEMI(27). Ai lëshon pak muzikë dhe nisë të përformoj edhe vet.

Dera hapet dhe hyn Maria. Ajo shtanget.

MARIA

Sem, çka është kjo?

SEMI

Shumë ma pak sa që meriton ti. Po, ta kam përgaditë edhe një vjershë...poezi.

(reciton)

Atë ditë që mu afrove, ti zemrën ma ndriçove... për çdo natë kur e shikoj hanën, fytyra jote ma kujton... nanën.

MARIA

Nanën...iii.. A je normal.

SEMI

Jo jo, zemër veç pak se nuk e kuptove. Frojdi ka thënë që ne e gjejmë gruan me ato karakteristika që na pëlqejnë te nana, e juve femrave te baba...

MARIA

O i shpifur, a po menon që une e menoj babën, kur t'shoh ty.

SEMI

Ajo është nën vetdije. Unë... nuk po di si me ta sqaru... urime shën valentini.

MARIA

Mos e ke festu ndonjëherë me nanën?

SEMI

Shumë ke humor zemër. haha...

Semi ja jep dhuratën.

MARIA

Çka ka k'tu?

SEMI

Dhuratë zemër.

MARIA

Eh, tash më qetësove. Çka ka brenda?

SEMI

Po zemër, që e ke pasë kompleks gjoksin, edhe k'tu e ke një kupon që me shku edhe me rrit sa të duash... të kisha propozu masën pak më shumë se mesatare.

MARIA

Së pari nuk e kam gjoksin kompleks...

SEMI

Tash ka po e menoj, është e njëjta masë me t'nanës time.

MARIA

Çka dreqin ke sot? Ma shpife.

SEMI

Kërkoj falje zemër... nuk ka përse. A shkojmë tash pak...

MARIA

Në shtrat?

SEMI

Po, ta thejmë krevatin.

MARIA

Jo.

SEMI

Pse?

MARIA

Me gjithë k'to fjalë, nuk e di a muj me ba seks me ty edhe për nja 1 muj.

SEMI

Pse zemër, kemi ba seks para ni muaji?

MARIA

Vetëm aty mbaje mendjen ti.

SEMI

Po pasi është shën valentini.

MARIA

T'lutem, jo sot.

SEMI

Zemër, unë du fëmijë.

MARIA

Fëmijë? A të kam thënë që nuk e prishi trupin para se ti bëj tridhjet vjet.

SEMI

Po at'herë vyshken mandarinat.

MARIA

Nuk më intereson.

SEMI

Ah, se gati harrova, tash shkojmë tek dhurata e dytë.

Ai ja jep edhe një dhuratë.

SEMI

Për ta bër lidhjen tonë edhe më të fuqishme dhe për ta kapërcy frikën edhe komplekset. k'tu e kemi ni seancë tek një terapistë e njohur.

MARIA

Unë nuk kam nevojë për k'so gjëra. Ti po. Ti dhe nana jote.

SEMI

Po t'gjithë kemi probleme, edhe unë. Shkojmë të dy.

MARIA

Jo thash.

SEMI

Do ta plotsoj çdo dëshirë vetëm eja ta bëjmë lidhjen edhe më të fortë.

MARIA

Çdo dëshirë?

SEMI

Vetëm fol dhe ajo bëhet.

MARIA

Muajin tjetër do t' shkojë me shoqe në pushim, do t' ma paguash?

SEMI

Zemër...

MARIA

Po apo jo?

SEMI

Po.

MARIA

Edhe mu edhe shoqeve?

SEMI

Po zemër ato nuk kursehen...

MARIA

Po apo jo?

SEMI

Po... po.

MARIA

U bë pra, nesër shkojmë. Vetëm unë nuk rri më shumë se gjysëm ore, do të dal me shoqet.

SEMI

Faleminderit shumë zemër, është dhurata më e mirë...mos u shqetëso, e kemi afër, dy kate më lart.

MARIA

Mos harro, vetëm një seancë... Dy kate the?

SEMI

Po, dje kur po e pastroja ballkonin, i ra këmisha k' tu..

MARIA

Mos më thuaj që ja ke dërgu ti!

SEMI

Po nuk është e mundur ajo zemër, e thirra për kafe, kemi bisedu për gjithçka edhe ja dhassh këmishën edhe e rezervova një seancë.

MARIA

Ta shohim nesër pra.

SEMI

Në rregull zemër, shohim pastaj.

Ai e puthë.

Maria shkon drejt shtratit dhe shtrihet aty.

MARIA

Unë po shtrihem.

SEMI

Ja po vi edhe unë, vetëm ta vë maskën e gjumit.

Ai shkon drejt banjës.

TE TERAPISTJA

Një zyre e thjeshtë e terapistet disa diploma të varura dhe ajo, ALBULEN(45) duke shkruar në ditarin e saj. Dera troket.

ALBULENA

Urdhëroni!

Hyn Gentiani me Elenën.

ALBULENA

Përshëndetje, mirëseerdhët... uluni.

Ata ulen.

ALBULENA

Atëherë. Unë jam Albulena dhe do t'jem terapistja e juaj, së pari po më vjen shumë mirë që keni zgjedhur t'ja jepni edhe një shansë lidhjes tuaj...

GENTIANI

Mirdita, unë t'kam ndimu me libra një ditë.

ALBULENA

Po po e di.

GENTIANI

Po pasi u prezantove, thash mos nuk t'kujtohem.

ALBULENA

Më kujtohesh shumë mirë..

GENTIANI

(nisë të flirtojë me të)

Edhe mua më kujtohesh shumë mirë...

ELENA

Gentian!

GENTIANI

Më fal zemër, vetëm desha të sillem mirë.

ELENA

Ulu!

ALBULENA

A është hera e parë që bëni terapi... në përgjith'si?

ELENA

Po, nuk kemi qenë asnjëherë tek psikologu...

GENTIANI

Unë po.

ELENA

Kur ke qenë ti?

GENTIANI

Vitin e kalum, kompania na tha që është obligative.

ELENA

Pse nuk m'ke tregu?

GENTIANI

Po....sdi, m'vike shumë rënd. Ti e din kush shkon tek psikologu...

ALBULENA

M'fal që duhet t'ju ndërprej, por, ata që thua ti nuk shkojnë tek psikologu, e kanë një vend tjetër. Psikologu është për njerëzit e shëndoshë.

GENTIANI

Po po e di, por kam frikë paragjykimin.

ALBULENA

Pse e keni fshehur këtë gjë nga gruaja juaj?

GENTIANI

Po si thash, ju kam frigu paragjykimit edhe ajo ishte femër e... kjo është pak xhelozie.

ELENA

Unë xhelozie? unë jam xhelozie kur duhet me qenë, po ti po e bën sikur unë jam e sëmure nga xhelozia.

ALBULENA

E ti a do ishe xheloz nëse Elena do ta kishte një psikolog mashkull?

GENTIANI

Po.... Nuk ka nevojë, ja të kemi ty, vim të dy së bashku, apo jo zemër.

ELENA

E sheh?

ALBULENA

Cili mendoni që është problemi kryesor i lidhjes tuaj?

ELENA

Nuk po mundemi me mbetë shtatzënë.

ALBULENA

A jeni kontrollu?

ELENA

Unë po.

GENTIANI

Unë nuk kam nevojë, jam fertil si lepur.

ALBULENA

A ke pasur fëmijë më herët?

GENTIANI

Jo, po.. Vrehet tek mashkulli, apo jo, e din edhe gruaja, tregoj.

ELENA

Ky mendon që nëse ka sperm është fertil.

ALBULENA

Jo jo, duhet ti bësh analizat edhe ti.

GENTIANI

Më beso që nuk ka nevojë. E di që jam fertil.

ALBULENA

Nëse ndryshon mendje, ja ku e ke kartvizitën e një mikut tim. Ai e ka ordinancën jo shumë larg nga k'tu... e ke edhe adresën aty.

GENTIANI

Faleminderit por nuk ka nevojë.

Ajo ja ofron kartvizitën dhe ai detyrohet ta mar.

ALBULENA

N'rregull. Tash I kam disa pyetje për të dy ju. Ku duhet të përgjigjeni sinqerisht. Si e pershkruani vetën: introvert, apo extrovert?

GENTIANI

Extrovert.

ELENA

Introvert.

ALBULENA

Vera apo dimri.

GENTIANI

Vera.

ELENA

Dimri.

ALBULENA

Si ju bën të ndiheni për përgjigjet e partnerit?

ELENA

Të trishtuar.

GENTIANI

Normale.

ALBULENA

Pse e trishtuar?

ELENA

Sepse nuk jemi të njëjtë në asnjë pikë.

Ajo nisë të qajë.

ALBULENA

Vetëm pak qet'sohu.. nuk është asgjë, më lini t'ju a tregoj një tregim. Një burrë dhe një grua, të martuar për dyzet vite dhe më në fund vendosin të ndahen. Gruaja i thotë: pse dëshiron të ndahesh ai i thotë: për gjithë k'to vite ma ke ngrënë pjesën e butë të bukës, kurse koret mi lije. Gruaja i thotë: Unë kam menduar se pjesa e butë nuk të pëlqen dhe e haja që ta kishe korën për vete. Pra mesazhi është që...

GENTIANI

Merrni secili bukën për vete.

ALBULENA

Jo. Mesazhi është që komunikimi është çelësi i gjithçkaje.

Elena nisë të qetësohet.

ELENA

Ke të drejtë. Ky tregim më dha shumë kurajo.

ALBULENA

Më vjen mirë që e kape mesazhin.

ELENA

Ishe shumë e qartë.. A mund ti them burrit diçka?

ALBULENA

Urdhëro.

ELENA

Të kujtohet që për një periudhë u zgjoje nga gjumi me asgjë tjetër vetëm çorapat e futbollit?

GENTIANI

Po?

ELENA

Sa herë që flije gjumë, i lëshoja programet e sportit t'i heqja rrobat t'i mbatha çorapat dhe të paramendoja si Ronaldo.

Gentiani ngritet nga karriga.

GENTIANI

Ti më ke thënë që po zgjohesha nga gjumi e po luaja futboll e mezi po më qet'soje.

ELENA

Të kam gënjy... më fal.

GENTIANI

Edhe më ke tradhtu... me një futbollist.

ALBULENA

Nuk është tradhëti. Të gjithë i kanë pëlqimet e veta, e nëse partnerët e pranojnë, kjo e bën lidhjen edhe më të shëndetshme... besoj edhe ti ke?

GENTIANI

Kam...

ALBULENA

Tregoj gruas tënde pra, kush është?

Ai mendohet.

ALBULENA

Nuk ke askënd?

GENTIANI

Jo vetëm po mendoj për cilën t'i tregoj.

Elena nisë të qajë.

ELENA

Unë nuk po të plotësoj...

GENTIANI

E sheh çka na bëre? Tash merru ti me të.

Albulena shikon orën.

ALBULENA

Jo, seanca e parë ka mbaru shihemi javën tjetër.

GENTIANI

Tash deri javën tjetër kjo do t'më ofendoj e do t'më gjuaj me gjithçka i bjen në dorë.

ELENA

Shkojmë.

ALBULENA

Vetëm pak, e kam një këshillë për ju.

ELENA

Po?

ALBULENA

Lidhja e juaj është sa komplekse aq edhe e fuqishme, por ju këshillojë që të gjeni diçka që do ja u ndezë lidhjen edhe më shumë, më kuptoni? Keni nevojë për diçka të re.

GENTIANI

Po po ju kuptoj faleminderit.

Ata dalin jashtë dhe në koridor takohem me Semin dhe Marian.

SEMI

Çfarë rastësie e bukur.

Të tre të tjerët skuqen nga sikleti.

SEMI

Gentian si je? A je mirë, gjithë kam mendu që je njeri më i prapambetur, por, kur të shoh tek terapistja... të lumtë.

GENTIANI

Po po, më vjen mirë që ju takova.

SEMI

E sheh zemër, se desh të la mendja kur t'thash shkojmë tek terapistja... e sheh edhe fqinj't tanë kanë ardhë.

MARIA

Po zemër...

SEMI

A kaluat mirë? Çka ju tha?

GENTIANI

Pse nuk vini në darkë pijm kafe edhe e diskutojmë.

Të gjithë ndalen dhe shokohen nga ftesa e Gentianit.

SEMI

Faleminderit shumë, aty do jemi ta premtoj.

MARIA

Eja zemër.

Ata futen brenda.

ELENA

A je n'rregull, si i thirre?

GENTIANI

Isha në siklet, nuk e dita çfarë t' bëj. Po nuk e besoj që do të vijn.

ELENA

Nuk e beson? Në rregull pra nëse vijn ti do t'përgaditësh gjithçka.

GENTIANI

Vetëm mos mi vë çorapet e futbollit.

Ai nisë të qeshë, por Elenës i kujton për përgjigjet e tij dhe ajo nisë të qajë e largohet nga aty.

GENTIANI

Zemër, humor ishte, prit.

Ai shkon drejt saj.

TE TERAPISTJA

Të dy ulen tek në karrige.

ALBULENA

Përsëndetje, unë jam Albulena dhe do t'jem terapistja e juaj, së pari po më vjen shumë mirë që keni zgjedhur t'ja jepni edhe një shansë lidhjes tuaj.

SEMI

Një pyetje, se atë ditë harrova. Ku keni specializuar?

ALBULENA

Unë kam përfunduar për psikologji dhe kam specializuar për terapi në çifte në Francë. Por, kjo nuk është e rëndësishme, më tregoni çfarë ju mundon juve?

MARIA

Mua më mundon një grua që i ka ra këmisha tek ballkoni ynë, e u ardhë ka pi kafe me burrin tim pa lejën time... edhe vazhdon sikur mos t'kishte ndodhur asgjë.

SEMI

Ndoshta nuk e kuptove, por e ka për ty që erdhe atë ditë.

ALBULENA

E kuptova, por kjo nuk është e rëndësishme.

MARIA

Nuk është e rëndësishme për ty ndoshta.

ALBULENA

Të lutem a mund të vazhdojmë?

SEMI

A mundemi zemër?

Maria e shikon me nervozë.

MARIA

E pra, mua më mundon burri im.

ALBULENA

Pse burri?

MARIA

Po, është shumë, nuk po e di si ta them. Bën shumë dhurata është kuzhinier i mrekullueshëm edhe për këtë shkak nuk po më bën të ndihem mirë.

SEMI

Nuk ma ke thënë asnjëherë zemër, do të përmisohem.

MARIA

Ja e sheh?

ALBULENA

Ku është problemi k'tu, nuk po e kuptoj?

MARIA

Problemi është se unë kam nevojë për kaos në jetën time, kurse ky është perfekt edhe ushqimi i tij po më shëndoshë.

SEMI

Po ti nuk po i ha sallatat zemër...

MARIA

Ja edhe më kundërshton.

ALBULENA

Vetëm pak, si jeni takuar ju dy?

SEMI

Ja ta them unë, është takim si në filma: Unë e kam mbaruar filozofinë dhe gjatë kohës që po e lexoja librin e Kantit - mbi të bukurën dhe të madhërishmen, e pashë një vajzë të brishtë tek pinte çaj kamomili në një kafene afër fakultetit, u afrova edhe i fola, por ajo më largoj. Edhe hoqa dorë, e hapa derën e veturës që sapo e kisha blerë hyra brenda, kur tek dritarja u afrua kjo. Më tha që: vetëm të provokova a po kthehesh edhe njëherë. aty ma dha numrin dhe tash vazhdojmë si çift i lumtur.

ALBULENA

Mirë.

SEMI

Njëherë mendova që pasi e pa veturën, por kur më tregoj që as nuk i njeh markat e veturave aty e kuptova, sa femër naivë dhe e bukur ishte.

MARIA

Naivë?

SEMI

Ishe zemër.

ALBULENA

Po jeta juaj seksuale si është?

SEMI

Si një dhuratë e pa hapur.

ALBULENA

Jeni të dy të virgjër?

MARIA

Jo.

SEMI

Po.

ALBULENA

Aha... Sem a është lidhja e parë?

SEMI

Po, kam tentu disa herë, por kjo është lidhja e parë... dhe e fundit.

Ja kap dorën Marias.

Albulena merr një letër.

ALBULENA

Këtu janë disa pyetje që i bëj çifteve të ndryshme. A jeni gati?

SEMI

Po, sigursht.

ALBULENA

Do fillojmë nga pytjet më të thjeshta. Çfarë keni bërë për ta rregulluar problemin në lidhjen tuaj?

SEMI

Po e filloj unë. Gjatë gjithë kohës që Maria më kritikon, unë ato kritika mundohem t'i kthejë në vepra të mira, dhurata, puthje e gjithçka, apo jo zemër?

Ajo nuk i kthen përgjigje.

ALBULENA

E ju Maria?

MARIA

Hmm, po... nuk e di. Herën e fundit i mbusha buzët, a numërohet kjo?

ALBULENA

Varet si reagon kjo te Semi?

SEMI

Nuk e di... si më bën të ndihem zemër?

MARIA

Po pse më pyet mua, mendo vet.

SEMI

Mirë, më bën të ndihem mirë.

ALBULENA

Si e përshkruani jetën tuaj së bashku?

SEMI

Të lumtur si në përralla.

MARIA

Të lumtur deri kur nuk ndërhy n profesioni i tij.

ALBULENA

Pse, si ndërhy n profesioni këtu?

MARIA

Po ja, mbrëmë më tha që më pëlqen gjoksi yt se më kujton gjoksin e nënës.

SEMI

Vetëm pak se nuk është ashtu si po mendon, unë e përmenda teorin e Frojdit..

MARIA

Gjithsesi është diçka shumë e tmerrshme të thuhet.

SEMI

Po nuk është e tmerrshme zemër, është si për shembull kur një person i rritur flet për një vajzë të re quhet pedofili, por kur një djalë i të njëjtës moshë e thotë të njëjtën gjë...

ALBULENA

Po të ndal këtu para se ta thuash atë që po e mendoj.

SEMI

Por nuk është e tmerrshme, apo jo.

ALBULENA

Ndrrrojmë temë.

MARIA

Faleminderit.

ALBULENA

Lidhja e juaj me gjithë problemet e saj, nuk është e dëmshme, por duhet t'i zgjidhni priotitetet, për shembull a doni të dy të keni fëmijë, a jeni të pjekur...

SEMI

A jemi?

ALBULENA

Nëse doni mendimin tim, mendoj që po..

Të dy shikohen.

MARIA

E si ta prish trupin tim për fëmijë?

ALBULENA

Në disa raste trup i bëhet edhe më i bukur. Për shembull gjokset rriten dhe lumturia shtohet.

MARIA

Por, rritet edhe barku.

ALBULENA

Bën fitnes dhe hiqet.

MARIA

Ajo është punë e imja. Sem Shkojmë.

Ata ngriten.

SEMI

Faleminderit shumë, jeni e mrekullueshme.

MARIA

E mrekullueshme?

SEMI

Më fal, e tmerrshme, si i thua gruas time ashtu?

MARIA

Gruas?

SEMI

Më fal e di që duket fjalë e shëmtuar, të dashurës.

ALBULENA

Do ta shohësh, do të ndryshoj mendja kur të mbetësh shtatzënë.

MARIA

Po e kalon kufirin e terapistes.

Ata largohen.

APARTAMENTI I GENTIANIT DHE ELENËS

Gentiani dhe Elena futen në apartamentin e tyre, Elena ka disa gjëra në dorë.

GENTIANI

E ti mendon që ajo do t'na ndihmojë.

ELENA

Ndoshta të koncentrohemi...

GENTIANI

Si të koncentrohemi?

ELENA

Do na ndihmojë në koncentrim Gentian.

Ata ulen në shtrat.

ELENA

E di? E kam një ide se si ta ndezim lidhjen.

GENTIANI

Si?

ELENA

Unë...ti... edhe...

GENTIANI

Edhe?

ELENA

Ta marim edhe...

GENTIANI

Jo?

ELENA

Po.

GENTIANI

Jo jo?

ELENA

Po, po, po.

GENTIANI

Vetëm ta kuptoj mirë? Ti po sugjeron që të bëjmë treshe?

ELENA

Po pra.

Gentiani i hudhet në përqaftim.

GENTIANI

Ti je gruaja më e mirë që ekziston, secili burrë e ka ëndërr ta ketë një grua si ti. A e din se kjo që the ti më shtyu të dashuroj njëqind herë më shumë... Jam shumë i emocionur, kush do jetë ajo?

ELENA

Ajo?

GENTIANI

Po pra, kush do jetë ajo?

ELENA

Pytja duhet të bëhet kush do jetë ai.

GENTIANI

Iii... e di çfarë? Unë jam kundër tresheve, është diçka shumë e ulët dhe e tmerrshme.

ELENA

Po mëherët sa nuk të lëshoj zemra nga gëzimi, e tash kur e kuptove që nuk është femër...

GENTIANI

Më herët vetëm të provokova, thash ta shoh si po reagon ti.

ELENA

Të njoh unë ty, t'i njoh edhe provokimet.

GENTIANI

Po ti e di zemër që unë kurr nuk e shoh askënd veç teje.

ELENA

Ti sheh vetëm...

Nga prapa shtratit del SEBI(60), për t'ju bërë befasi.

SEBI

Befasi!!

Të dy frikësohen.

SEBI

Jam unë?

GENTIANI

Nanë çka po bën k'tu?

SEBI

A k'shtu pritet nana?

GENTIANI

Jo, po na friksove. I paske dëgju të gjitha?

SEBI

Që nga fillimi.

GENTIANI

Edhe pjesën e...

SEBI

Treshës? Ajo ishte fantastike.

ELENA

E tmerrshme.

SEBI

Pse tmerrshme? Burrat janë burra... Por, jo me burra tjerë.

ELENA

E çka nëse do t'isha shtatzanë?

SEBI

E di që nuk je, kemi bisedu në telefon më ka tregu për gjithçka edhe për këtë jam k'tu.

ELENA

Gentian!!

GENTIANI

Po ti e di zemër që unë gjithçka i tregoj nanës...

ELENA

Pse nuk po i tregon edhe për pozicionet...

SEBI

Bash për atë kam ardhë, aty e keni problemin edhe...

Ajo e nxerrë nga çanta një kilogram mjaltë.

SEBI

Duhet ta hash këtë, kjo t'i ushqen vezët, edhe unë e kam pasë të njëjtin problem. Por pasi e përdora k'të.. lindi ky burr i madh para teje.

ELENA

Pse nuk po i bën reklamë në televizion.

SEBI

Më beso vajza ime, kjo është gjithçka që ke dashur.

ELENA

Gentian të lutem...

GENTIANI

Zemër mua më duhet të shkoj.

ELENA

Vetëm pak.

Ajo e kap nga dora edhe e tërheqë.

ELENA

Ku don t'shkosh ti e t'më lësh vetëm me të?

Kam një punë zemër.

GENTIANI

Çfarë pune ke tash?

ELENA

Një takim pune.

GENTIANI

Takim pune? Me kë?

ELENA

Jo takim pune po takim për.... Punë, për një punë të mundshme.

GENTIANI

Pse po gënjen?

ELENA

Nuk po gënjej zemër...

GENTIANI

Shko djali im shko, burri nuk duhet ta pyes gruan gjithmonë.

SEBI

Faleminderit mami.

GENTIANI

Gentian!

ELENA

Ai largohet.

Sebi afrohet dhe e kap nga dora.

SEBI

Eja, ulu pak qetsohu.

SEBI

E qetë jam.

ELENA

Burrav duhet t'ju japësh qetësi, ende nuk je mësuar?

SEBI

ELENA

Edhe gratë kanë nevojë për qetësi, pse ne kafshë jemi.

SEBI

Shumë po bëhesh nervoze, e di që nuk është mirë për shtatëzani? Elenë a të vjen keq të pyes diçka?

ELENA

Jo.

SEBI

Në çfarë pozicioni po flen.

ELENA

Në shpinë zakonisht.

SEBI

Jo jo, nuk po më kupton.. Me Gentianin.

ELENA

Ahaa.. Se nga pozicion varet?

SEBI

Normalisht, djali im nuk është e mundur mos të ketë fëmijë.

ELENA

E unë është e mundur?

SEBI

Ne gratë jemi më të ndishme, edhe të kam pa ty se si ecën me këmbë zbathur, e di që të ftohen vezët?

Në atë moment troket dera.

ELENA

Zot faleminderit.

Ajo shkon e hapë derën.

Aty është Semi dhe Maria.

ELENA

Ejani ejani mirësevini.

SEMI

A të thash zemër që do na mirëpresin, ti thoje që nuk na thirrën me dëshirë.

ELENA

Si jo, a jeni për kafe?

Ajo shkon t'i përgadis kafet menjëherë.

Sebi afrohet.

SEBI

Përsëndetje unë jam nëna e Gentianit e vjehrra e Elenës. Sebi.

SEMI

Oh sa mirë, shumë janë çift simpatik.. Kjo është gruaja ime. Maria.

Maria ja jep dorën.

MARIA

Përsëndetje.

SEBI

Uluni mos rrini n'këmbë.

Ata ulen.

SEMI

Si po kalon ti, shpresoj që ke ardhur për mirë.

SEBI

Po si jo për mirë, kam ardhur ti ndihmojë të ngelin shtatzanë.

Dëgjohen disa zhurma nga kuzhina.

SEBI

A je mirë?

MARIA

Po shkoj ti ndihmoj.

Ajo shkon tek Elena.

SEMI

Pra je mjeke apo jo?

SEBI

Jo nuk jam mjeke por, prej ktyre duarve kanë ngelë shtatzanë gjysma e grave të fshatit.

SEMI

Mos më thuj... i fut duart...

SEBI

Jo jo, ishte metaforë, ju tregoj se si duhet të flen, çfarë të konsumojnë...

SEMI

Pse? Edhe kjo luan rol.

SEBI

Si jo, ja për shembull kjo mjaltë, të bën shumë fertil, është mjaltë bagrenash ku kullosin bletët e shëndosha.

SEMI

A mund ta provoj pak.

SEBI

Po si jo.

Sebi e futë gishtin në kavanoz, e lyen me mjaltë dhe ja futë Semit në gojë.

SEMI

Nuk e di kush ishte ma i ëmbël, gishti a mjalta.

SEBI

Provoje edhe njëherë.

Sebi përsëri e bën të njëjtën gjë.

SEMI

Shumë e mirë, a mundem edhe pak.

Ajo përsëri e bën të njëjtën gjë.

SEMI

Faleminderit zonja Sebi... a dëshiron ta provosh edhe ti.

Ai e lyen gishtin, por në atë moment hyjnë Maria dhe Elena.

Semi e futë gishtin në gojën e tij.

SEMI

Erdhët zemër? hajde uluni.

Ato ulen.

SEBI

Si po thoja... po. Edhe pozicioni luan shumë rol, për shembull..

ELENA

A ndrrojmë temë?

SEMI

Jo nuk është problem, vazhdo.

MARIA

Të lutem zemër, qet'sohu.

SEBI

Edhe ju po tentoni të bëni fëmijë.

SEMI

Ndoshta..

MARIA

Nuk e di...

SEMI

...nuk e di.

Aha. SEBI

Si kaluat tek psikologja? SEMI

Cila psikologe. SEBI

Asnjë psikologe, po flet për vetën. Apo jo Sem. ELENA

Jo, për juve, që u takuam në koridor. SEMI

Të lutem. ELENA

Hajde Sem, po shkojmë. MARIA

Po na sa erdhëm. SEMI

Eja. MARIA

Ata ngriten dhe shkojnë drejt derës.

Rrini se ende është shumë herët. SEBI

Në atë moment vjen Gentiani.

Ja erdhi edhe Gentiani. SEBI

Erdhi edhe Gentiani zemër. SEMI

Ec thash. Natën e mirë! MARIA

SEMI

Natën e mirë!

Ata largohen.

GENTIANI

Çka patën k'ta?

ELENA

Nuk e di.

SEBI

Tregoj që po konsultoheni me psikologën.

GENTIANI

Kush tregoj Semi? Ma mori mendja.

SEBI

Pse po mbani msheft nga unë, në vend që të konsultoheni me mu, ju shkoni paguani njerëz.

GENTIANI

Nanë nuk është aq e lehtë të diskutohet me ty.

SEBI

Pse? Të gjithë jemi njerëz, a mendon që unë edhe baba yt nuk bënim seks kurr? Ai ishte shumë qejfli..

GENTIANI

Ja, pikërisht për k'të.

SEBI

Po merre mjaltën.

GENTIANI

Nanë ne po shkojmë të flejmë, natën e mirë. Eja zemër.

SEBI

N'rregull, fleni, po zgjohuni herët se koha më e mirë për me ngelë shtatzanë është mëngjesi.

ELENA

Natën e mirë.

Ata e mbyllin derën.

SEBI

Mos harro, ktheje Elenën kah lindja e djellit... edhe rri ti përmbi të, jo ajo përmbi ty.

GENTIANI (V.O.)

Naaanë!

Ajo largohet nga dera, e zhgënjyer nga ata dy.

APARTAMENT I MARIAS DHE SEMIT

Të dy hyjnë tek apartamenti i tyre.

MARIA

Si nuk tu ndal goja asnjëherë.

SEMI

Nuk është faji im që jam i singertë.

MARIA

Çfarë lidhje ka singëriteti yt k'tu. A nuk di ta lexosh ambientin një herë në jetën tëndë.

SEMI

Jo unë e lexoj shumë mirë, por faji është tek ata, pse nuk i tregojnë gruas?

MARIA

Ajo është punë e tyre, ti nuk duhet të përzihesh.

SEMI

N'rregull, e kuptova, kërkoj falje.

MARIA

Nuk ke pse më kërkon mu.

SEMI

Ja po shkoj tek ata pra.

MARIA

Ndal, lëri të qetë.

SEMI

N'rregull.

Ai ecën drejt shtratit.

SEMI

Lëri të qetë Sem, mos u përziej Sem, po flet shumë Sem, po më dhemb koka Sem, nuk jam e gatshme Sem...

MARIA

Epo jam e gatshme.

SEMI

Çfarë?

MARIA

Jam e gatshme pra.

SEMI

E ke fjalën për....?

MARIA

Po pra.

SEMI

Nuk e di.. Kam emocione.

Maria i afrohet dhe e shtyen në shtrat.

SEMI

Më e kujdesshme zemër...

Ajo i hidhet përmbi.

APARTAMENTI I GENTIANIT DHE ELENËS

Sebi para derës së dhomës të Gentritit dhe Elenës.

Ajo shikon orën.

SEBI

Asnjë zhurmë, mos kanë hequr dorë?

Në atë moment dera hapet.

Aty del Elena.

ELENA

Çfarë po bën k'tu?

SEBI

Asgjë vetëm desha ta shoh a ka shku Gentiani në punë.

ELENA

Mos u bën merak e ka kry punën.

SEBI

Epo, më mirë të sigurohem.

ELENA

Janë bërë thuajse një javë që ke ardhë dhe në çdo sekond sa herë jemi ne në dhomë, ti rri para derës duke dëgju.

SEBI

Nuk është e vërtetë.

ELENA

Të shihet hija poshtë derës, edhe zhurma kur merr frymë si një traktor.

SEBI

Pasi më ke pa, a mund të më tregosh ku shkon çdo natë rreth orës dy, e kthehesh një orë më vonë?

Elena mbetet duke e shiku.

ELENA

Dal të vrapoj.

SEBI

Në mes të natës.

ELENA

Po se është më freskët.

SEBI

Jemi në shkurt.

ELENA

Është punë për mu.

Në atë moment vjen Gentiani.

GENTIANI

Çfarë është gjithë kjo zhurmë? është ora 7 ju lutem.

SEBI

Është faji i gruas tënde...

GENTIANI

Nanë të lutem.

Dera troket.

Ai shkon e hapë dhe aty është Semi dhe Maria.

SEMI

Vetëm erdhëm ta falenderojmë, zonjën Sebi..

Ajo afrohet.

SEMI

Më lejo ti puthë k'to durë, dhe këtë gisht që ma dhanë mjaltën...

MARIA

Sot është hera e parë që bëj testin dhe doli pozitiv.

Të dy e përqafojnë Sebin të lumtur.

SEBI

Se ju po më bëni të keqe.

SEMI

Faleminderit shumë, sonte jeni të ftuar për darkë tek ne.

Semi dhe Maria largohen.

SEBI

Ehh, biri im. E sheh.

ELENA

Më duhet të shkoj në banjë.

Ajo merr dhe një test shtatzanie.

GENTIANI

Nanë, kam vendosë, do të dëgjoj. Ku është mjalta?

SEBI

Eh kështu po, ja atje.

Dera troket.

GENTIANI

Vetëm ta hapi derën.

Ai shkon tek dera, merr një letër dhe e hapë.

Elena vjen duke kërcyer.

ELENA

Jam shtatzënë... jam shtatzënë!!!

Gentiani i shokuar lexon letrën.

GENTIANI

Jam steril.

TESTI I BIE NGA DORA DHE TË
TRE SHIKOJNË NJËRI TJETRIN.
ATA FLASIN VETËM NJË FJALË.

TË TRE

SEMI!!

Ata mbesin të shokuar.

FUND